



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 185

Tiranë – E premte, 10 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 351, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22711
Dekret i Presidentit nr. 352, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22711
Dekret i Presidentit nr. 353, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22711
Dekret i Presidentit nr. 354, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22711
Dekret i Presidentit nr. 355, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22712
Dekret i Presidentit nr. 356, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22712
Dekret i Presidentit nr. 357, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22712
Dekret i Presidentit nr. 358, datë 7.10.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 8.10.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar..... 22713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 8.10.2025	Për lejimin e paraqitjes së dokumenteve të fondit arkivor të Republikës së Shqipërisë në ekspozitën “Demokracia nëpërmjet ligjit”, në mjediset e <i>Doge’s Apartments at Palazzo Ducale</i> , në Venecia, Itali..... 22714

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 8.10.2025	Për miratimin e rregullave të hollësishme për veprimtarinë, emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian.....	22715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 840, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, të ndryshuar.....	22717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta”, të ndryshuar.....	22717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 8.10.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”, të ndryshuar.....	22719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 8.10.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Hasan Baku’, Bashkia Tiranë”	22721
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 878, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”, të ndryshuar.....	22723
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 8.10.2025	Për miratimin e listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G.....	22723
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 8.10.2025	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Vlorës	22726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 8.10.2025	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Fierit	22726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 8.10.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 478, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, të ndryshuar.....	22726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 577, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	22727

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	22736
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 8.10.2025	Për autorizimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit si themeluese e fondacionit “ <i>CulturAlb</i> ”	22736
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 8.10.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 598, datë 1.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”	22737

**DEKRET****Nr. 351, datë 7.10.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Adrian Pandeli Kondi
2. Andi Arben Zaganjori
3. Ervin Perikli Papa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 352, datë 7.10.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eduard Denjoll Dajçi
2. Mira Tajfun Pfeiffer

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 353, datë 7.10.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edmond Hamdi Topi
2. Emil Dhimitraq Terpini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 354, datë 7.10.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Avni Sadri Gegaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 355, datë 7.10.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Besjan Ahmet Binaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 356, datë 7.10.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bernarda Nexhip Wilden
2. Marko Drini Baboçi
3. Anjeza Shyqyri Guri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 357, datë 7.10.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Elidor Edip Shehu
2. Aferdita Nazif Shabani



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 358, datë 7.10.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alina Andon Hila
2. Arben Ahmet Sokolaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 559, datë 8.10.2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 584, DATË 28.8.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për

organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores, bashkëlidhur vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 10, të kreut II, shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Ministri propozues për projektaktet, të cilat vlerësohen të një rëndësie të veçantë dhe periudha e përgatitjes së tyre është e kufizuar ose që gjatë hartimit dhe bashkërendimit të tyre pritet të ndeshen me çështje tekniko-ligjore të vështira për zgjidhje, planifikon që të organizohen takime bashkërenduese-konsultative për përshpejtimin e procesit, takime të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të kreut V, të kësaj rregulloreje.”.

2. Në kreun III bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15.1 Strukturat përgjegjëse gjatë hartimit të një projektakti të paravlerësuar si i rëndësisë së veçantë, kur ndeshen me çështje tekniko-ligjore të vështira për zgjidhje, njoftojnë ministrin duke argumentuar nevojën që të kërkohet organizimi i një takimi të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të kreut V, të kësaj rregulloreje.”.

b) Në pikën 17, pas fjalëve “... raportit të vlerësimit ekonomik ,...” shtohen “... raportit të rezultatit të takimit të grupit akselerator, kur ka të tillë, ...”.

3. Pas pikës 27, të kreut IV, shtohet pika 27/1, me këtë përmbajtje:

“27.1 Për projektaktet e vlerësuara të një rëndësie të veçantë dhe me prioritet shqyrtimi, ministri propozues bën shënimin përkatës në dokumentin shoqërues të dërgimit të projektaktit për mendim.”.

4. Në kreun V bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 29 shtohet pika 29/1, me këtë përmbajtje:

“29.1 Ministri ose titullari i institucionit të interesuar për projektaktet e rëndësisë së veçantë, të dërguara sipas pikës 27.1, të kreut IV, të kësaj rregulloreje, kur në përmbajtje të tyre ndeshet me çështje tekniko-ligjore të vështira për dhënie mendimi për zgjidhjen e tyre, brenda fushës së tij të



përgjegjësisë, i propozon ministrit iniciues të projektaktit që të kërkojë organizimin e një takimi të grupit akselerator për gjetjen sa më parë të zgjidhjeve përfundimtare të çështjeve, objekt diskutimi.”

b) Pas shkronjës “c”, të pikës 33, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) për projektaktet e rëndësisë së veçantë dhe prioritare, me propozim të ministrit apo titullarit që ka dhënë mendim ose me nismën e tij kërkon organizimin e takimit të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të këtij kreu të rregullores.”

c) Pas shkronjës “b”, të pikës 36, shtohet shkronja “b.1”, me këtë përmbajtje:

“b.1) delegimin e zgjidhjes së çështjeve tekniko-ligjore të vështira në grupin akselerator.”

ç) Pas pikës 38 shtohet pika 38/1, me këtë përmbajtje:

“38/1. Në rastet e shkronjës “ç”, të pikës 33, dhe të shkronjës “b.1”, të pikës 36, të kësaj rregulloreje, zëvendëssekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me marrjen e kërkesës ose të delegimit organizon takimin e grupit akselerator për zgjidhjen e çështjes/ve të kërkuara ose të deleguara.

Grupi akselerator kryesohet nga zëvendës-kryeministri dhe në përbërje ka zëvendëssekretarin e përgjithshëm, përgjegjës për mbarrëvajtjen e takimit, ministrin/at propozues të projektaktit, ministrin ose titullarin e institucionit që në mendimin me shkrim ka evidentuar çështjet, objekt shqyrtimi, dhe drejtorin e Departamentit të Akteve Rregullore të Këshillit të Ministrave në Kryeministri.

Në varësi të çështjeve që diskutohen, në takimin e grupit akselerator mund të thirren ose ftohen të marrin pjesë titullarë të institucioneve të fushave me interes ose punonjës të administratës apo ekspertë të jashtëm që vlerësohen se mund të ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve tekniko-ligjore.

Takimi i grupit akselerator asistohet nga departamenti përgjegjës në Kryeministri, i cili përgatit materialin për diskutim dhe nën kujdesin e zëvendëssekretarit të përgjithshëm harton dhe i dërgon anëtarëve të grupit akselerator raportin përkatës të rezultatit të takimit.

Rezultatet e takimit akselerator për zgjidhjen e çështjeve, objekt diskutimi, reflektohen në përmbajtje të projektaktit dhe të mendimeve me shkrim të ministrave dhe titullarëve të institucioneve të interesuara, pjesëmarrës në takim.”

5. Në kreun VI bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 45, pas fjalëve “... edhe shpjegime ...” shtohen “... për mënyrën e zbatimit dhe reflektimit të raportit të rezultatit të takimit të grupit akselerator si dhe ...”.

b) Pas shkronjës “b”, të pikës 47, shtohet shkronja “b.1”, me këtë përmbajtje:

“b.1) nuk janë reflektuar me korrektësi rezultatet e takimit të grupit akselerator, kur ka të tillë.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 560, datë 8.10.2025

PËR LEJIMIN E PARAQITJES SË DOKUMENTEVE TË FONDIT ARKIVOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË EKSPOZITËN “DEMOKRACIA NËPËRMJET LIGJIT”, NË MJEDISËT E DOGE’S APARTMENTS AT PALAZZO DUCALE, NË VENECIA, ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 83 e 84, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e paraqitjes jashtë shtetit, në ekspozitën “Demokracia nëpërmjet ligjit”, pranë muzeut “Doge’s Apartments at Palazzo Ducale”, në Venecia, Itali, për periudhën 11 tetor 2025 deri më 6 janar 2026, si pjesë e veprimtarive zyrtare në kuadër të përvjetorit të 35-të të Komisionit Evropian për demokracinë nëpërmjet ligjit, organizuar në bashkëpunim ndërmjet Zyrës Italiane të Këshillit të Evropës, Komisionit të Venecias, Superintendencës Arkivore dhe Bibliografike të Venetos dhe Trentino-Alto Adige-s, Arkivit Shtetëror të Venecias, fondacionit “Musei Civici di Venezia” dhe Këshillit Rajonal të Venetos, të dokumenteve të mëposhtme, pjesë e Fondit Arkivor të Republikës së Shqipërisë:

a) ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (40 faqe);



b) dekreti nr. 2241, datë 21.10.1998, i presidentit të Republikës, “Për shpalljen me referendum të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” (1 faqe);

c) dekreti nr. 2260, datë 28.11.1998, i presidentit të Republikës për shpalljen e ligjit (1 faqe).

2. Dokumentet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi dërgohen jashtë dhe rikthehen brenda vendit në periudhën ndërmjet datave 1 tetor 2025 – 15 janar 2026, pas mbylljes së ekspozitës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me postë diplomatike, korrier diplomatik.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të bashkërendojë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 561, datë 8.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR VEPRIMTARINË,
EMËRIMIN, SHKARKIMIN DHE
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË
AGJENCISË SË AUDITIMIT TË
PROGRAMEVE TË ASISTENCËS,
AKREDITUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë (në vijim “Këshilli

Mbikëqyrës”), si dhe të procedurës për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tij.

2. Këshilli Mbikëqyrës e ushtron veprimtarinë në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Për çështje që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim, lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës, gjejnë zbatim parashikimet e legjislacionit për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore.

3. Në këtë vendim, termi dhe akronimi i mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ligj”, ligji nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) “AAPAA”, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian.

II. EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, një nga të cilët është kryetar, dhe emërohen nga Kryeministri, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Emërimi i kryetarit dhe të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në një procedurë të hapur e publike të konkurrimit të kryer nga Kryeministria, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 12, të ligjit.

3. Shpallja e vendit të lirë për pozicionin e kryetarit apo të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të mandatit, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 10, të ligjit, dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen zyrtare elektronike të Kryeministrit dhe të AAPAA-së, për një periudhë 30-ditore.

4. Njoftimi për shpalljen e pozicionit të lirë përmban kriteret që duhet të plotësojë kandidati për kryetar apo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, dokumentacionin dhe afatin e dorëzimit të tij.

5. Në rastin e krijimit të vakancës së kryetarit ose anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të AAPAA-së, para përfundimit të mandatit, AAPAA-ja njofton menjëherë Kryeministrinë për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për këto pozicione.

6. Për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes për kryetar dhe anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, Sekretari i Përgjithshëm në Kryeministri ngre një komision *ad-hoc* të përbërë nga 3 (tre) anëtarë të caktuar prej tij.



7. Vlerësimi i kandidatëve bazohet në jetëshkrimin (CV-në), që përfshin vlerësimin e arsimimit, kualifikime të larta profesionale, eksperiencën dhe trajnimet në profesion ose të lidhura me fushën, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit.

8. Komisioni *ad-hoc* shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, sipas pikës 3, të këtij kreu, harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore e kualifikohen dhe ia paraqet atë Kryeministrit.

9. Në rastet kur pas përfundimit të procesit të vlerësimit rezulton se nuk ka kandidatë që plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara bëhet rishpallja e thirrjes për aplikime për pozicionin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Rishpallja e vendit të lirë për këto pozicione publikohet në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtën periudhë të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu. Për vlerësimin e kandidatëve zbatohen të njëjtat rregulla, sipas përcaktimeve në pikat 6-8, të këtij kreu.

10. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Mbikëqyrës të AAPAA-së shkarkohet nga Kryeministri në këto raste:

- a) kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- b) kur mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Mbikëqyrës;
- c) për shkak të paafësisë profesionale;
- ç) kryen veprimtari që krijon konflikt interesi, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;
- d) kur me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës dhe imazhin e AAPAA-së.

11. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Mbikëqyrës lirohet në këto raste:

- a) kur jep dorëheqjen;
- b) kur përfundon mandati 4-vjeçar i qëndrimit në detyrë;
- c) kur plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) në rast vdekjeje të tij.

III. ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE DHE VENDIMMARRJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet jo më pak se një herë në 3 (tre) muaj.

2. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës thirret me nismën e kryetarit dhe/ose me kërkesën e një

anëtari, si dhe kur kërkohet nga drejtori i Përgjithshëm i AAPAA-së, sipas nevojave të institucionit. Në dy rastet e fundit, kërkesa i drejtohet kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës.

3. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se 2 (dy) anëtarë. Në rastet kur nuk plotësohet ky numër, kryetari e shtyn mbledhjen për një kohë tjetër, duke njoftuar për këtë qëllim anëtarin/ët që nuk ishte/ishin i/të pranishëm.

4. Mbledhja drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.

5. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rastet kur nga votimi nuk arrihet shumica, vendimmarrja përcaktohet nga vota e kryetarit.

6. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në nenin 20, të ligjit.

7. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të tërhiqen nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit në rastet kur ekziston një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 30, të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë rast, anëtari detyrohet të deklarojë me shkrim interesat e tij që në fillim të diskutimit për çështjen konkrete.

8. Këshilli Mbikëqyrës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretariati teknik, i përbërë nga punonjës të AAPAA-së, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm.

9. Zbardhja e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës bëhet nga sekretariati teknik, brenda 5 (pesë) ditëve punë, pas ditës së përfundimit të mbledhjes.

10. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës publikohen në faqen zyrtare të AAPAA-së.

11. Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës hartohet një procesverbal i detajuar, i cili mbahet nga sekretariati teknik dhe depozitohet në zyrën e arkiv-protokollit të AAPAA-së.

12. Procesverbali i paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.

IV. SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës bëhet sipas përcaktimeve të vendimit nr. 656, datë



31.10.2018, Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

V. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 562, datë 8.10.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 840, DATË 17.12.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 840, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “... në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme” zëvendësohen me “... në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare ...”.

2. Në shkronjën “ç”, të pikës 5, fjalët “... me miratimin paraprak të ministrit të Punëve të Jashtme” hiqen.

3. Në pikën 6, fjalët “... të miratuar nga ministri i Punëve të Jashtme” hiqen.

4. Në fjalinë e dytë, të pikës 7, emërtimi “Ministri i Punëve të Jashtme” zëvendësohet me “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare”.

5. Në pikën 10, fjalët “... që miratohet nga ministri i Punëve të Jashtme” zëvendësohen me “... që miratohet nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare”.

6. Në pikën 12, emërtesa “Ministria e Punëve të Jashtme” zëvendësohet me “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 563, datë 8.10.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “ë”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) ushtron funksionin e organit qendror blerës për blerjen e biletave në fushën e transportit ajror, si dhe rezervimin, blerjen e shërbimeve të akomodimit në hoteleri jashtë vendit dhe siguron shërbimet logjistike shtesë për delegacionet shtetërore jashtë vendit, për Kryeministrinë dhe ministrinë. Për Kabinetin e Kryeministrit, institucionin e Presidencës dhe Kuvendit të Shqipërisë, këto shërbime i ofrohen në rast se kërkohen prej tyre. Shpenzimet për kryerjen e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxhetet e institucioneve përfituese. DSHQ-ja negocion kontrata kuadër me kompani ajrore, rrjete hoteliere dhe agjenci udhëtimi dhe nënshkruan kontrata konfidencialiteti, me qëllim ruajtjen e informacionit të detyrueshëm mes palëve në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas



legjislacionit përkatës. Me çdo institucion, i cili do të marrë shërbimin sipas kësaj shkronje, DSHQ-ja nënshkruan aktmarrëveshje bashkëpunimi dhe konfidencialiteti, me qëllim ruajtjen e informacionit të detyrueshëm mes palëve, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e DSHQ-së për përmbushjen e detyrimeve për ofrimin e shërbimeve, si organ qendror blerës të përcaktuar në këtë shkronjë, si dhe tarifat e shërbimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues.

Institucionet e lartpërmendura dërgojnë në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare kërkesat për blerje të biletave dhe akomodim në hoteleri, jo më vonë se 15 ditë nga data e udhëtimit. Në raste emergjence dhe të justifikuara me shkrim nga institucioni kërkuar, mund të procedohet me kërkesën, e cila duhet të dorëzohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e udhëtimit. Në raste përjashtimore, DSHQ-ja mund të realizojë shërbimin në afate më të shkurtra se më sipër, me miratimin nga titullari i institucionit.”

2. Pas shkronjës “j”, të pikës 2, shtohen shkronjat “k”, “l”, “ll”, “m”, “n”, “nj” dhe “o”, me këtë përmbajtje:

“k) Mbulon funksionet e “Shërbimeve ndaj Trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë dhe përfaqësive diplomatike shqiptare të akredituara jashtë vendit”, nëpërmjet drejtorisë përkatëse në varësi të saj;

l) Menaxhon, administron dhe mirëmban godinat qeveritare, që gjenden në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, duke përfshirë planifikimin, organizimin funksional të hapësirave, rikonstruksionin dhe mobilimin, sipas nevojave të institucioneve publike;

ll) Inventarizon dhe regjistron pasuritë, që gjenden në listën e inventarit të Këshillit të Ministrave, duke krijuar një regjistër qendror për të gjitha godinat qeveritare, duke përfshirë të dhëna mbi sipërfaqen, destinacionin, gjendjen teknike, vitin e ndërtimit dhe statusin ligjor;

m) Realizon procesin e mirëmbajtjes e të restaurimit në godinat qeveritare që gjenden në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, ndërhyrjet kapitale për rikonstruksione e restaurime, si dhe merr masa për sigurinë teknike e mbrojtjen nga zjarri;

n) Harton plane për menaxhimin me efikasitet të energjisë së godinave qeveritare që gjenden në listën

e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim edhe me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe kujdeset për integrimin e standardeve ‘green building’;

nj) Ushtron funksionin e organit qendror blerës për blerjen e mobilie, arredimin/ambientimin e mjediseve të punës dhe përfaqësimit për llogari të Kryeministrit, ministrave, si dhe të përfaqësive diplomatike të akredituara jashtë vendit. Për institucionin e Presidencës dhe Kuvendit të Shqipërisë, këto shërbime i ofrohen në rast se kërkohen prej tyre. Administron, mirëmban dhe restauron mobilie dhe objekte dekorative me vlerë historike dhe artistike, që përdoren nga institucionet shtetërore, duke krijuar një fond kombëtar mobilie dhe objekteve dekorative (koleksion shtetëror);

o) Kryen procedurat e ankandit publik për shitjen e mobilie dhe objekteve dekorative të amortizuara e të panevojshme dhe merr pjesë në ankande për blerjen e mobilie dhe objekteve dekorative me interes historik, artistik dhe estetik, duke respektuar rregullat, procedurat dhe përjashtimet e legjislacionit në fuqi;”.

II. Funksioni i DSHQ-së për blerjen e biletave në fushën e transportit ajror, si dhe rezervimin, blerjen e shërbimeve të akomodimit në hoteleri jashtë vendit, i shtuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të zbatohet duke filluar nga data 1 janar 2026. Deri në atë datë, institucionet e përmendura në atë pikë duhet të kryejnë vetë procedurat përkatëse dhe brenda datës 10 dhjetor 2025 të dërgojnë pranë DSHQ-së të gjitha nevojat e tyre për periudhën 1 janar 2026 dhe në vijim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 564, datë 8.10.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 37, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)", të ndryshuar, përmasat e pronës, me emërtimin "Agjencia Mbolan", me vendndodhje në Sinjë, Berat, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1 (një) fletë dhe planin e rievimit 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS


Identifikoi: Arjanit LILOLLARI - Drejtor në Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Vili VREONI - Drejtor i Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Robert HYSENLLARI - Drejtor i Përgjithshëm i DPRMSH
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, firma, vula)

Institucioni Qendror Shtetëror:
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e Pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m²)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta	
						Truall (m²)	Ndërtesë (m²)						
			Truall	Agjencia Mbolan	11 633	11 633	7222.5	magazinin	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit	Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë	VKM 413, datë 11.7.2007, i ndryshuar		
		183/42		Objekti nr.1		26	15					godinë roje	
		183/43		Objekti nr.2		22	10.5					godinë dushi	
		183/44		Objekti nr.3		490	71					godinë mensë	
		183/38		Objekti nr.4		124	0					godinë "peshore" rrënojë	
		183/39		Depo drithi nr.1		826	557						
		183/40		Depo drithi nr.2		1038	759						
		183/36		Depo drithi nr.3		1059	756						
		183/34		Depo drithi nr.4		1028	746						
		183/31		Depo drithi nr.5		784	565						
		183/29		Depo drithi nr.6		774	556						
		183/32		Depo drithi nr.7		1012	747						
		183/27		Depo drithi nr.8		1466	867						
		183/24		Depo drithi nr.9		441	300						
		183/25		Depozitë vajrash		312	20						
		183/46		Depozitë karburanti		846	357						
		183/47		Depozitë karburanti		846	357						
		317/1		Tunel nr.1		288	288						
		317/2		Tunel nr.2		251	251						
TOTAL					11 633	11 633	7222.5						



**VENDIM****Nr. 568, datë 8.10.2025**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI PROJEKTIT “SISTEMIM,
ASFALTIM I RRUGËS ‘HASAN BAKIU’,
BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Hasan Bakiu’, Bashkia Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 20 359 036.80 (njëzet milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 20 359 036.80 (njëzet milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë) lekësh përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Page | 22722



VENDIM

Nr. 569, datë 8.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 878, DATË 24.12.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN,
VEPRIMTARINË DHE RREGULLAT E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT
SHTETËROR TË RINDËRTIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 14, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të kreut II, të vendimit nr. 878, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “d”, “dh” dhe “P” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“d) Ministrin e Arsimit;”.

“dh) Ministrin e Ekonomisë dhe Inovacionit;”.

“f) Ministrin e Mjedisit.”.

2. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) Ministrin e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 570, datë 8.10.2025

**PËR MIRATIMIN E LISTËS ME
PËRBËRËSIT KRITIKË DHE PJSËT E
NDJESHME TË RRJETEVE 5G**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 55, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

ANEKS

**LISTA ME PËRBËRËSIT KRITIKË DHE
PJSËT E NDJESHME TË RRJETEVE 5G**

**1. Pjesët kritike dhe të ndjeshme të rrjeteve
5G përfshijnë:**

- rrjetin bërthamë (*Core Network*);
- rrjetin e aksesit radio (RAN);
- rrjetin e transmetimit dhe të transportit;
- sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit.

Në sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit përfshihen:

a) Menaxhimi NFV dhe orkestrimi i rrjetit MANO;

b) Sistemet e menaxhimit dhe shërbimet mbështetëse, elementet e rrjetit për shkëmbimet ndërmjet rrjeteve.

**2. Lista e detajuar me përbërësit kritikë dhe
të ndjeshme të rrjetit 5G**

Lista indikative e elementeve të pjesëve kritike dhe të ndjeshme të rrjetit 5G, niveli i rrezikut, sipas pjesëve kritike dhe funksionet e elementeve kryesore, përcaktohen, si më poshtë vijon:



PJESËT KRITIKE TË RRJETIT	VLERËSIMI I RREZIKUT	LISTA INDIKATIVE E ELEMENTEVE TË RRJETIT	FUNKSIONET KRYESORE
Rrjeti bërthamë (<i>Core Network</i>)	Kritike	AMF SMF UPF PCF UDM AUSF NSSF NEF NRF SEPP NWDAF 5G EPC NFVI	-Funksionet e autentifikimit të pajisjeve të përdoruesit, <i>roaming</i> dhe menaxhimi i sesionit; -Funksionet e transportit të të dhënave të pajisjeve të përdoruesit; -Menaxhimi i politikave të aksesit; -Regjistrimi dhe autorizimi i shërbimeve të rrjetit; -Ruajtja e të dhënave të përdoruesve dhe rrjetit; -Lidhja me rrjetet celulare të palëve të treta; -Ekspozimi i funksioneve të rrjetit <i>Core</i> ndaj aplikacioneve të jashtme; -Atribuimi i pajisjeve të përdoruesit ndaj pjesëve të rrjetit;
Rrjeti i aksesit radio (RAN)	I lartë	gNB RU DU CU RIC	-Stacionet bazë; -Menaxhimi i stacionit radio; -Procesimi i protokolleve të shtresës së poshtme; -Procesimi i protokolleve të shtresës së sipërme; -Optimizimi i performancës së rrjetit aksesit radio, duke përdorur inteligjencën artificiale;
Funksionet e transportit dhe të transmetimit (rrjeti i agregimit të transportit dhe transmetimit)	I moderuar në të lartë	GTP-U MEP PE Router P Router BRAS Firewall	-Transporti i të dhënave të përdoruesit brenda rrjetit 5G; -Optimizimi i burimeve për të siguruar vonesë të vogël në transmetim; -Lidhja midis rrjeteve që mbështetet nga MPLS; -Menaxhimi i trafikut të rrjetit bërthamë dhe MPLS; -Menaxhimi i sesioneve të përdoruesit dhe vendosja e politikave për aksesin <i>broadband</i> ; -Filtrimi dhe kontrolli i trafikut hyrës e dalës, sipas rregullave të paracaktuara të sigurisë;
Menaxhimi i NFV dhe orkestrimi i rrjetit (MANO)	Kritike	NVFO VNFM/CNFM VIM/CISM NMS EMS SDN	-Orkestrimi i shërbimeve të rrjetit në infrastrukturën 5G; -Konfigurimi i shërbimeve dhe funksioneve të rrjetit; -Kontrolli i performancës, kapacitetit dhe utilizimit;
Sistemet e menaxhimit dhe shërbimet mbështetëse	I lartë	OSS/BSS Security NTPS	-Sistemet e menaxhimit të sigurisë; -Sistemet e faturimit; -Sistemet e operimit dhe shërbimet e tjera mbështetëse, si performanca e rrjetit;
Elementet e rrjetit për shkëmbimet ndërmjet rrjeteve	I moderuar në të lartë	-	-Rrjetet IP jashtë ambienteve të MNO-së; -Shërbimet e rrjetit të ofruara nga palët e treta.

3. Kërkesat për informacion për elementet kritike ose të ndjeshme të rrjetit 5G, sipas këtij vendimi, i drejtohen operatorëve të rrjeteve celulare dhe për aq sa është e zbatueshme dhe operatorëve të rrjetet virtuale celulare.



4. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër, kur vlerësohet e nevojshme, AKEP-i kërkon informacion për funksione apo pajisje që nuk përmenden në këto pika, por që vlerësohen si kritike apo me ndjeshmëri të lartë, si rezultat i zhvillimeve teknologjike për rrjetet 5G ose të gjeneratës së ardhshme.

LISTA E SHKURTIMEVE

gNB	Gjenerata tjetër nyja B (<i>Next Generation NodeB</i>)
AMF	Funksioni i menaxhimit të aksesit dhe lëvizshmërisë (<i>Access and Mobility Management Function</i>)
SMF	Funksioni i menaxhimit të sesioneve (<i>Session Management Function</i>)
UPF	Funksioni i planit të përdoruesit (<i>User Plane Function</i>)
PCF	Funksioni i kontrollit të politikave (<i>Policy Control Function</i>)
UDM	Menaxhimi i të dhënave të unifikuara (<i>Unified Data Management</i>)
AUSF	Funksioni i serverit të autentikimit (<i>Authentication Server Function</i>)
NSSF	Funksioni i përzgjedhjes së segmentit të rrjetit (<i>Network Slice Selection Function</i>)
NEF	Funksioni i ekspozimit të rrjetit (<i>Network Exposure Function</i>)
NRF	Funksioni i depozitës së rrjetit (<i>Network Repository Function</i>)
GTP-U	Protokolli i tunelimit GPRS – plani i përdoruesit (<i>GPRS Tunneling Protocol - User Plane</i>)
SEPP	Ndërfaqe mbrojtëse e sigurisë në skajin e rrjetit (<i>Security Edge Protection Proxy</i>)
NWDAF	Funksioni i analizës së të dhënave të rrjetit (<i>Network Data Analytics Function</i>)
MEP	Platforma e kompjuterizimit në skajin me akses të shumëfishtë (<i>Multi-Access Edge Computing Platform</i>)
NFVI	Infrastruktura e virtualizimit të funksioneve të rrjetit (<i>Network Function Virtualization Infrastructure</i>)
EPC	Bërthama e paketës së zhvilluar (<i>Evolved Packet Core</i>)
RU	Njësia radio (<i>Radio Unit</i>)
DU	Njësia e shpërndarë (<i>Distributed Unit</i>)
CU	Njësia e qendëruar (<i>Centralized Unit</i>)
RIC	Kontrolluesi inteligjent i RAN-it (<i>RAN Intelligent Controller</i>)
NMS	Sistemi i menaxhimit të rrjetit (<i>Network Management System</i>)
EMS	Sistemi i menaxhimit të elementeve (<i>Element Management System</i>)
OSS/BSS	Sistemet e operacioneve dhe mbështetjes së biznesit (<i>Operations and Business Support Systems</i>)
Security	Sistemi i menaxhimit të sigurisë (<i>Security Management System</i>)
PE	Ruteri skajor i ofruesit (<i>Provider Edge Router</i>)
P Router	Ruter i ofruesit (<i>Provider Router</i>)
BRAS	Server për akses të largët në broadband (<i>Broadband Remote Access Server</i>)
NTPS	Sinkronizimi i kohës dhe fazës së rrjetit (<i>Network Time and Phase Synchronization</i>)
FW	Ndërfaqe mbrojtëse (<i>Firewalls</i>)
SDN	Kontrollues i rrjetit të përcaktuar nga software-i (<i>Software-Defined Networking Controller</i>)



VENDIM

Nr. 574, datë 8.10.2025

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË VLORËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Plator Nesturi, prefekt i Qarkut të Vlorës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Evis Allushi emërohet prefekt i Qarkut të Vlorës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 575, datë 8.10.2025

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arben Çuko, prefekt i Qarkut të Fierit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Anduel Xhindi emërohet prefekt i Qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 576, datë 8.10.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 478, DATË 10.7.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN
E SIGURISË SË GJYQTARËVE TË
GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË
PROKURORËVE TË PROKURORISË SË
POSAÇME DHE DREJTORIT TË
BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 478, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Garanti i mbrojtjes personale të kryetarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit bëhet nëpërmjet shoqërimit me truporje të nivelit bazë dhe truporje të nivelit të mesëm gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe për një afat jo më shumë se 2 (dy) vjet pas përfundimit të tij. Garanti i mbrojtjes personale të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme bëhet nëpërmjet shoqërimit me truporje të nivelit bazë dhe truporje të nivelit të mesëm gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe për një afat jo më shumë se 3 (tre) vjet pas përfundimit të tij.”.

2. Ngarkohen drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM

Nr. 577, datë 8.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, e të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 16, të kreut I, fjalët “... (CFSP) 2025/207 ...” zëvendësohen me “... (CFSP) 2025/1577 ...”.

2. Në aneksin 16, bashkëlidhur vendimit, vendimi (CFSP) 2025/207 zëvendësohet me vendimin (CFSP) 2025/1577, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



30/7/25, ora 15:21

L_202501577EN.000101.fmx.xml

Fletorja Zyrtare
e Bashkimit Evropian

SHQIP

Seria L

2025/1577

30.7.2025

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/1577**të 29 korrikut 2025.**

**përditësimin e listës së personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga Qëndrimi i
Përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin, dhe
shfuqizimin e Vendimit
(Politika e Jashtme dhe e Sigurisë) 2025/207**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe
Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 27 dhjetor 2001, Këshilli miratoi Qëndrimin e Përbashkët 2001/931/CFSP(1).
- (2) Më 30 janar 2025, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2025/207(2), duke përditësuar listën e personat, grupet dhe subjektet e mbuluara nga Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/CFSP ('lista').
- (3) Në përputhje me Nenin 1(6) të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP, është e nevojshme të rishikohen në intervale të rregullta emrat e personave, grupeve dhe subjekteve në listë për të siguruar që ka arsye për t'i mbajtur ata në të.
- (4) Ky Vendim përcakton rezultatin e shqyrtimit që Këshilli ka kryer në lidhje me personat, grupet dhe subjektet e mbuluara nga masat në nenet 2 dhe 3 të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP.
- (5) Këshilli ka arritur në përfundimin se hyrja për një person duhet të fshihet nga lista. Në të njëjtën kohë, Këshilli ka verifikuar që autoritetet kompetente, siç përmendet në Nenin 1(4) të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP, kanë marrë vendime në lidhje me të gjithë personat, grupet dhe subjektet e tjera në listë, në kuptimin që ata kanë qenë të përfshirë në akte terroriste sipas kuptimit të Nenit 1(3) të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP. Këshilli ka arritur gjithashtu në përfundimin se masat në Nenet 2 dhe 3 të atij Qëndrimi të Përbashkët duhet të vazhdojnë të zbatohen për ata persona, grupe dhe entitete.
- (6) Lista duhet të përditësohet në përputhje me rrethanat, dhe Vendimi (CFSP) 2025/207 duhet të shfuqizohet.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1



30/7/25, ora 15:21

L_202501577EN.000101.fmx.xml

Lista e personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga masat në nenet 2 dhe 3 të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP është përcaktuar në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Vendimi (CFSP) 2025/207 shfuqizohet me anë të kësaj.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 29 korrik 2025.

*Për Këshillin**Presidenti*

M. BJERRE

(1) Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2001/931/CFSP i 27 dhjetorit 2001 mbi zbatimin e masave specifike në luftën kundër terrorizmit (Gazeta Zyrtare L 344, 28.12.2001, f. 93, ELI: <http://data.europa.eu/eli/compos/2001/931/oj>).

(2) Vendimi i Këshillit (PPJS) 2025/207 i datës 30 janar 2025 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/PPJS mbi zbatimin e masave specifike në luftën kundër terrorizmit, dhe shfuqizimin e Vendimit (PPJS) 2024/2056 (OJ L, 2025/207, 31.1.2025, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/207/oj>).

SHTOJCË**Lista e personave, grupeve dhe subjekteve të përmendura në Nenin 1****I. Personat**

1. ABDOLLAHI Hamed (i njohur ndryshe si Mustafa Abdullahi), i lindur më 11.8.1960 në Iran. Numri i pasaportës: D9004878.
2. AL-DIN Hasan Izz (i njohur ndryshe si Garbaya Ahmed, i njohur ndryshe si Sa'id, i njohur ndryshe si Salwwan Samir), i lindur më 1963 në Liban, shtetas i Libanit.
3. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, i lindur në Al Ihsa (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite. Arabia.
4. AL-YACCOUB Ibrahim Salih Mohammed, i lindur më 16.10.1966 në Tarut (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
5. ARBABSAR Manssor (i njohur edhe si Mansour Arbabsiar), i lindur më 6.3.1955 ose 15.3.1955 në Iran. Shtetas iranian dhe amerikan, numri i pasaportës: C2002515 (Iran); numri i pasaportës: 477845448 (SHBA). Numri i identifikimit kombëtar: 07442833, data e skadimit 15.3.2016 (leje drejtimi SHBA).
6. ASSADI Assadollah (i njohur ndryshe si Assadollah Asadi), i lindur më 22.12.1971 në Teheran (Iran), Iranian shtetas. Numri i pasaportës diplomatike iraniane: D9016657.
7. BOUYERI Mohammed (i njohur ndryshe si Abu Zubair, i njohur ndryshe si Sobiar, i njohur si Abu Zoubair), i lindur më 8.3.1978 në Amsterdam (Holandë).



30/7/25, ora 15:21

L_202501577EN.000101.fmx.xml

8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, i lindur më 6.8.1962 në Teheran (Iran), shtetas iranian. Pasaportë numri: D9016290, i vlefshëm deri më 4.2.2019.
9. HASSAN EL HAJJ Hassan, i lindur më 22.3.1988 në Zaghdraiya, Sidon, Liban, shtetas kanadez. Numri i pasaportës: JX446643 (Kanada).
10. MELIAD Farah, e lindur më 5.11.1980 në Sydney (Australi), shtetase australiane. Numri i pasaportës: M2719127 (Australi).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (i njohur ndryshe si Ali Salem, i njohur ndryshe si Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, i njohur si Henin Ashraf Refaat Nabith, i njohur si Wadood Khalid Abdul), i lindur më 14.4.1965 ose 1.3.1964 në Pakistani, numri i pasaportës 488555.
12. SHAHLAI Abdul Reza i njohur ndryshe si Abdol Reza Shala'i, i njohur ndryshe si Abd-al Reza Shalai, i njohur ndryshe si Abdorreza Shahlai, i njohur ndryshe si Abdolreza Shahla'i, i njohur ndryshe si Abdul-Reza Shahlaee, i njohur ndryshe si Hajj Yusef, i njohur ndryshe si Haji Yusif, i njohur ndryshe si Hajji Yasir, i njohur ndryshe si Hajji Yusif, i njohur ndryshe si Yusuf Abu-al-Karkh), i lindur rreth vitit 1957 në Iran.
Adresat: (1) Kermanshah, Iran, (2) Baza Ushtarake Mehran, Provinca Ilam, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, i lindur rreth vitit 1965 në Teheran, Iran.

II. Grupet dhe entitetet

1. 'Organizata Abu Nidal' - 'ANO' (i njohur ndryshe si 'Këshilli Revolucionar i Fatahut', i njohur si 'Brigadat Revolucionare Arabe', e njohur edhe si 'Shtatori i Zi', ose 'Organizata Revolucionare e Myslimanëve Socialistë').
2. 'Brigada e Martirëve të Al-Aksës'.
3. 'El-Aksa eV'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Partia Komuniste e Filipineve', përfshirë 'Ushtrinë e Re Popullore' – 'NPA', Filipine.
6. Drejtoria për Sigurinë e Brendshme e Ministrisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Iranit.
7. 'Gama'a al-Islamiyya' (i njohur ndryshe si 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Grupi Islamik' - 'IG').
8. 'İslami Büyük Doğu Akıncılar Cephesi' - 'İBDA-C' ('Fronti i Madh i Luftëtarëve të Lindjes Islamike').
9. 'Hamas', duke përfshirë 'Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Krahu Ushtarak i Hizballah-ut' (i njohur ndryshe si 'Krahu Ushtarak i Hezbollah-ut', i njohur ndryshe si 'Krahu Ushtarak i Hizbullah-ut', i njohur ndryshe si 'Krahu Ushtarak i Hizbollah-ut', i njohur ndryshe si 'Krahu Ushtarak i Hizbu'llah-ut' i njohur ndryshe si 'Krahu Ushtarak i Hizb Allah-ut', i njohur ndryshe si 'Këshilli i Xhihad-it' (dhe të gjitha njësitë që i raportojnë atij, përfshirë Organizatën e Sigurisë së Jashtme)).
11. 'Muxhahedinët e Hizbulit' – 'HM'.
12. "Forca Khalistan Zindabad" - "KZF".
13. 'Partia e Punëtorëve të Kurdistanit' - 'PKK' (i njohur ndryshe si 'KADEK', e njohur edhe 'KONGRA-GEL').
14. 'Tigrat Çlirimtare të Tamil Eelam' – 'LTTE'.
15. "Ejército de Liberación Nacional" ("Ushtria Çlirimtare Kombëtare").
16. 'Xhihadi Islamik Palestinez' – 'PIJ'.

https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202501577

3/4



30/7/25, ora 15:21

L_202501577EN.000101.fmx.xml

17. 'Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës' – 'PFLP'.
18. 'Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës – Komanda e Përgjithshme' (i njohur edhe si 'PFLP – Gjenerali Komandë').
19. 'Devrimci Halk Kurtuluş Partisi-Cephesi' – 'DHKP/C' (i njohur ndryshe si 'Devrimci Sol' ('Revolucionar Majtas'), i njohur edhe si 'Dev Sol') ('Ushtria/Fronti/Partia Revolucionare Çlirimtare e Popullit').
20. 'Sendero Luminoso' – 'SL' ('Rruga e ndritur').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' - 'TAK' (i njohur ndryshe si 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit', i njohur ndryshe si 'Skifterët e Lirisë së Kurdistanit').
22. 'Baza'.

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1577/oj>

ISSN 1977-0677 (botim elektronik)



7/30/25, 3:21 PM

L_202501577EN.000101.fmx.xml

Official Journal
of the European UnionEN
L series

2025/1577

30.7.2025

COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/1577**of 29 July 2025.****updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2025/207**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 27 December 2001, the Council adopted Common Position 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) On 30 January 2025, the Council adopted Decision (CFSP) 2025/207 ⁽²⁾, updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP (the 'list').
- (3) In accordance with Article 1(6) of Common Position 2001/931/CFSP, it is necessary to review at regular intervals the names of persons, groups and entities on the list to ensure that there are grounds for keeping them thereon.
- (4) This Decision sets out the result of the review that the Council has carried out in respect of persons, groups and entities covered by the measures in Articles 2 and 3 of Common Position 2001/931/CFSP.
- (5) The Council has concluded that the entry for one person should be deleted from the list. At the same time, the Council has verified that competent authorities, as referred to in Article 1(4) of Common Position 2001/931/CFSP, have taken decisions with regard to all the other persons, groups and entities on the list to the effect that they have been involved in terrorist acts within the meaning of Article 1(3) of Common Position 2001/931/CFSP. The Council has also concluded that the measures in Articles 2 and 3 of that Common Position should continue to apply to those persons, groups and entities.
- (6) The list should be updated accordingly, and Decision (CFSP) 2025/207 should be repealed,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1



7/30/25, 3:21 PM

L_202501577EN.000101.fmx.xml

The list of persons, groups and entities covered by the measures in Articles 2 and 3 of Common Position 2001/931/CFSP is set out in the Annex to this Decision.

Article 2

Decision (CFSP) 2025/207 is hereby repealed.

Article 3

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 29 July 2025.

For the Council

The President

M. BJERRE

⁽¹⁾ Council Common Position 2001/931/CFSP of 27 December 2001 on the application of specific measures to combat terrorism (OJ L 344, 28.12.2001, p. 93, ELI: <http://data.europa.eu/eli/compos/2001/931/oj>).

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2025/207 of 30 January 2025 updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2024/2056 (OJ L, 2025/207, 31.1.2025, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/207/oj>).

ANNEX

List of persons, groups and entities referred to in Article 1

I. Persons

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafa Abdullahi), born 11.8.1960 in Iran. Passport number: D9004878.
2. AL-DIN Hasan Izz (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'id, a.k.a. Salwwan Samir), born 1963 in Lebanon, citizen of Lebanon.
3. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, born in Al Ihsa (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
4. AL-YACOB Ibrahim Salih Mohammed, born 16.10.1966 in Tarut (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
5. ARBABSAR Manssor (a.k.a. Mansour Arbabsiar), born 6.3.1955 or 15.3.1955 in Iran. Iranian and US national, passport number: C2002515 (Iran); passport number: 477845448 (USA). National ID number: 07442833, expiry date 15.3.2016 (USA driving licence).
6. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), born 22.12.1971 in Tehran (Iran), Iranian national. Iranian diplomatic passport number: D9016657.
7. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiar, a.k.a. Abu Zoubair), born 8.3.1978 in Amsterdam (The Netherlands).



7/30/25, 3:21 PM

L_202501577EN.000101.fmx.xml

8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, born 6.8.1962 in Tehran (Iran), Iranian national. Passport number: D9016290, valid until 4.2.2019.
9. HASSAN EL HAJJ Hassan, born 22.3.1988 in Zaghdraiya, Sidon, Lebanon, Canadian citizen. Passport number: JX446643 (Canada).
10. MELIAD Farah, born 5.11.1980 in Sydney (Australia), Australian citizen. Passport number: M2719127 (Australia).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, a.k.a. Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), born 14.4.1965 or 1.3.1964 in Pakistan, passport number 488555.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahla'i, a.k.a. Abdul-Reza Shahlaee, a.k.a. Hajj Yusef, a.k.a. Haji Yusif, a.k.a. Hajji Yasir, a.k.a. Hajji Yusif, a.k.a. Yusuf Abu-al-Karkh), born circa 1957 in Iran. Addresses: (1) Kermanshah, Iran, (2) Mehran Military Base, Ilam Province, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, born circa 1965 in Tehran, Iran.

II. *Groups and entities*

1. 'Abu Nidal Organisation' – 'ANO' (a.k.a. 'Fatah Revolutionary Council', a.k.a. 'Arab Revolutionary Brigades', a.k.a. 'Black September', a.k.a. 'Revolutionary Organisation of Socialist Muslims').
2. 'Al-Aqsa Martyrs' Brigade'.
3. 'Al-Aqsa e.V.'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Communist Party of the Philippines', including 'New People's Army' – 'NPA', Philippines.
6. Directorate for Internal Security of the Iranian Ministry for Intelligence and Security.
7. 'Gama'a al-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Islamic Group' – 'IG').
8. 'İslami Büyük Doğu Akıncılar Cephesi' – 'IBDA-C' ('Great Islamic Eastern Warriors Front').
9. 'Hamas', including 'Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Hizballah Military Wing' (a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbullah Military Wing', a.k.a. 'Hisbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbu'llah Military Wing' a.k.a. 'Hizb Allah Military Wing', a.k.a. 'Jihad Council' (and all units reporting to it, including the External Security Organisation)).
11. 'Hizbul Mujahideen' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Kurdistan Workers' Party' – 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Liberation Tigers of Tamil Eelam' – 'LTTE'.
15. 'Ejército de Liberación Nacional' ('National Liberation Army').
16. 'Palestinian Islamic Jihad' – 'PIJ'.



7/30/25, 3:21 PM

L_202501577EN.000101.fmx.xml

17. 'Popular Front for the Liberation of Palestine' – 'PFLP'.
18. 'Popular Front for the Liberation of Palestine – General Command' (a.k.a. 'PFLP – General Command').
19. 'Devrimci Halk Kurtuluş Partisi-Cephesi' – 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('Revolutionary Left'), a.k.a. 'Dev Sol') ('Revolutionary People's Liberation Army/Front/Party').
20. 'Sendero Luminoso' – 'SL' ('Shining Path').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' – 'TAK' (a.k.a. 'Kurdistan Freedom Falcons', a.k.a. 'Kurdistan Freedom Hawks').
22. 'The Base'.

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1577/oj>

ISSN 1977-0677 (electronic edition)

**VENDIM****Nr. 578, datë 8.10.2025**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, ndryshohen të dhënat për 17 (shtatëmbëdhjetë) individë, të renditur në shkronjën “a”, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NDRYSHIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Ndryshimet në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”;

1. *AIMAN: MUHAMMED: RABI: AL-ZAWAHIRI*
2. *MUHSIN: FADHIL: AYED: ASHOUR AL-FADHLI*
3. *ABD ALLAH: MOHAMED: RAGAB: ABDEL RAHMAN*
4. *ZAKI: EZAT: ZAKI: AHMED*
5. *ABDUL: HAQ*
6. *QASIM: MOHAMED: MAHDI: AL-RIMI*
7. *IBRAHIM: AWWAD: IBRAHIM: ALI AL-BADRI AL-SAMARRAI*
8. *MUSTAFA: HAJJI: MUHAMMAD: KHAN*
9. *ABDUL MOHSEN: ABDALLAH: IBRAHIM: AL CHAREKH*
10. *ABOU: MOHAMED: AL ADNANI*
11. *SOFLANE: BEN GOUMO*
12. *HAMZA: USAMA: MUHAMMAD: BIN LADEN*
13. *IBRAHIM: ALI: ABU BAKR: TANTOUSH*
14. *AL-AZHAR: BEN KHALIFA: BEN AHMED: ROUINE*
15. *SULAIMAN: JASSEM: SULAIMAN: ALI ABO GHAIH*
16. *SHAFI: SULTAN: MOHAMMED: AL-AJMI*
17. *GULMUROD: KHALIMOV*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

VENDIM**Nr. 579, datë 8.10.2025**

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT SI THEMELUESE E FONDACIONIT “CULTURALB”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit si themeluese e fondacionit “*CulturAlb*”, me objekt ruajtjen, prodhimin, ekspozimin, promovimin, marketimin, shitjen e suvenireve e të produkteve të tjera artistike, promovimin e trashëgimisë kulturore materiale, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe çdo veprimtari tjetër të parashikuar në statut dhe në aktin e themelimit.

2. Akti i krijimit dhe statuti i fondacionit miratohen në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 580, datë 8.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 598, DATË 1.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN
E NDIKIMIT NË MJEDISIN
NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 598, datë 1.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kreu I ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“I. PROCEDURA PARAPRAKE DHE
NJOFTIMI I ZHVILLUESIT”**

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit/projektidesë, paraqet nëpërmjet sistemit elektronik pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin kërkesën dhe dokumentacionin e parashikuar në kërret I dhe II, të vendimit nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas marrjes së aplikimit nga ministria, ndjek procedurën e përcaktuar në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, dhe vlerëson nëse projekti i propozuar është i listuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe nëse mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje, bazuar në identifikimin e ndikimeve ndërkufitare, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kur plotësohen kushtet e pikës 2, të këtij kreu, Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton zhvilluesin se projekti i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) në kontekst ndërkufitar dhe i kërkon të plotësojë formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të, bazuar në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Formatin dhe dokumentacionin, të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, dorëzohen në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, dhe procedura e vlerësimit bëhet sipas parashikimeve të këtij vendimi.”.

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjell praktikën për mendim/konsultim në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së, duke theksuar edhe afatin prej 20



(njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre tek institucionet e mëposhtme:

- a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;
- b) Drejtorinë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;
- c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile;
- ç) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- d) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.”.

b) Në fund të pikës 7 shtohen fjalët “..., dhe ministria këto të dhëna ia përcjell Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”;

c) Në pikën 8, pas fjalëve “... gjykohet e nevojshme ...” shtohen “... nga AKM-ja ...”;

ç) Në pikën 10, fjala “Ministria” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

- a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga ana e zhvilluesit, dërgon një kopje të tij për mendim/konsultim, së bashku me përmbledhjen

joteknike të këtij raporti, duke theksuar afatin prej 20 (njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre, tek institucionet e mëposhtme:

- a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;
- b) Drejtorinë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;
- c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;
- ç) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- d) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.”.

b) Në pikat 4, 5, 7 dhe 8, fjala “Ministria” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”;

c) Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 6, shtohen fjalët “... dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

